



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 04.09.2023, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika:
 1. Pjesa e parcelës kadastrale, nr. 01637-0, me sip. 2024 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01637-0, Zona kadastrale Prishtinë, pjesa e parcelës kadastrale nr. 01641-0, me sip. 513 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01641-0, Zona kadastrale Prishtinë, pjesa e parcelës kadastrale nr. 01642-0, me sip. 330 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01642-0, Zona kadastrale Prishtinë, pjesa e parcelës kadastrale nr. 01643-0, me sip. 76 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01643-0, Zona kadastrale Prishtinë, pjesa e parcelës kadastrale nr. 01645-0, me sip. 274 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01645-0, Zona kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe totale 3217 m², me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër", i miratuar sipas Vendimit nr. 01, nr. 035-186861, të dt. 02.10.2013.
 2. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale nr. 1850-1, me sip. 3217 m², Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01850-1, në pronësi të: Shemsi (Rifat) Begollit, me destinim infrastrukturë rrugore të planifikuar sipas Planit rregullues "Kalabria", i miratuar sipas Vendimit nr. 01, nr. 35-18196, të dt. 03.08.2005.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të projektit të rrugës "A", sipas Planit rregullues "Kalabria" Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.

- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
 - kopjet e planit dhe
 - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/06-183687/23, më 05.09.2023



Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Investimeve Kapitale për zhvillimin e projektit të rrugës "A", si dhe bazuar në Planin rregullues "Kalabria", të miratuar nga Kuvendi komunal i Prishtinës, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesëve të parcelave kadastrale, nr. 1637-0, 1641-0, 1642-0, 1643-0 dhe 1645-0, me sipërfaqe totale 3217m², Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës, me destinim ndërtim sipas planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr.035-186861, dt.02.10.2013, dhe parcelës kadastrale nr. 1850-1, me sip. 3217m², ZK Prishtinë, në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit, me destinim infrastrukture rrugore, të planifikuar sipas planit rregullues "Kalabria", i miratuar me Vendimin nr.01, nr. 35-18196, dt. 03.08.2005, të cilat përfshihen në kuadër të projektit të rrugës "A" - "Jim Xhema" Prishtinë.

Propozimi për iniciimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të projektit të rrugës "A", sipas Planit rregullues "Kalabria", Prishtinë. Pjesa e parcelave nr.: 1637-0, 1641-0, 1642-0, 1643-0 dhe 1645-0, me sipërfaqe totale 3217m², Zona kadastrale Prishtinë, shtrihen në zonë të planifikuar për ndërtim, ndërsa parcela nr. 1850-1, me sip. 3217m², ZK Prishtinë, sipas Planit rregullues "Kalabria", Prishtinë, shtrihen në infrastrukturë rrugore të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.